

Në Bashkinë Prrenjas aktualisht nuk ka Organizata Jo Fitmiprurëse, por operojnë disa organizata që nuk janë lokalizuar në Bashkinë Prrenjas si:

1. World Vision ( e cila ka ngritur një hapësirë zhvillimore në shkollën “Qybra Sokoli” për 15 fëmijë me aftësi të kufizuar).
2. UNDP –ja e cila operon me dy programe
  - ReLOaD ku nëpërmjet këtij programi janë financuar katër organizata të shoqërisë civile të cilat operojnë në fusha të ndryshme në Bashkinë Prrenjas
  - Askush mos të ngelet pas i cili fokusohet në ofrimin e shërbimit lëvizës për 15 fëmijë me aftësi të kufizuar në zonat e largëta dhe për 15 fëmijë në hapësirën zhvillimore në shkollën “Qybra Sokoli”
3. JOCELYN (project i financuar nga USAID për ngritjen e këshillit Rinor në Bashkinë Prrenjas).

Media në zonën e Prrenjasit pothujase nuk është shumë e zhvilluar por operojnë vetëm dy media:

- **Antena 1**
- **TV. Qukës**